

UDHËZIM
Nr. 35, datë 29.12.2023

**PROCEDURA PËR MENAXHIMIN E VËSHTIRËSIVE FINANCIARE PËR
NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 6 të nenit 57, pikës 5 të nenit 59 dhe pikës 2 të nenit 60/1, të ligjit nr. 68, datë 17.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, ministri përgjegjës për financat

UDHËZON:

I. OBJEKTI DHE QËLLIMI

1. Objekt i këtij udhëzimi janë rregullat, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore në të gjitha rastet që ato shfaqen, si dhe transparencja, bashkëpunimi dhe raportimi me strukturat e qeverisjes qendrore.

2. Qëllimi i këtij udhëzimi është:

i. implementimi i një sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare dhe paftësi paguese; si dhe

ii. përcaktimi i procedurave për administrimin e këtyre rasteve.

II. PËRKUFIZIME

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

3. “Angazhim buxhetor” është marrja përsipër e detyrimeve financiare, përmes hyrjes në marrëdhënie kontraktuale.

4. “Administrator” është personi i emëruar nga Këshilli i Ministrave për menaxhimin financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore që është në situatën e paftësisë paguese.

5. “Borxhi i papaguar i njësisë së vetëqeverisjes vendore (stoku i borxhit)” nënkupton tepricën e mbetur të të gjitha instrumenteve të borxhit (me ose pa normë interesi).

6. “Detyrime financiare të prapambetura (të konstatuara dhe të papaguara)” konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditëve kalendrike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, si edhe ato pas afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshjen apo legjislacionin përkatës. (p.sh. marrëdhëniet e punës dhe kontributeve, vendimet gjyqësore, për rimbursimin e TVSH-së etj.).

7. “Detyrimet e papaguara të borxhit” nënkupton detyrimet e papaguara që rrjedhin nga të gjitha instrumentet e borxhit, të cilave u ka kaluar afati i pagesës.

8. “Hua afatshkurtër” është huaja, që duhet të shlyhet për një periudhë kohe deri në një vit.

9. “Hua afatgjatë” është huaja, që duhet të shlyhet për një periudhë kohe më të gjatë se një vit.

10. “Huaja për rifinancim” është huaja të hyrat e së cilës përdoren për të shlyer një hua tjetër, zakonisht për të shfrytëzuar kushte më të leverdishme në treg.

11. “Fonde të trashëguara” janë të ardhurat e buxhetit vendor, të arkëtuara në llogaritë e thesarit nga të ardhurat e veta të NJVQV-ve, taksat kombëtare dhe transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit, të papërdorura gjatë vitit buxhetor, që trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës.

12. “Fonde të trashëguara dhe të paangazhuara” janë fondet e trashëguara, të arkëtuara në llogaritë e thesarit nga të ardhurat e veta të NJVQV-ve, taksat kombëtare dhe fonde nga transfertat e përgjithshme e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit që nuk kanë angazhim buxhetor.

13. “Gjendje normale financiare”, në kuptimin e këtij udhëzimi, quhet rasti, kur detyrimi financiar i prapambetur është nën 15% të shpenzimeve vjetore faktike, dhe që është në një afat nën 60 ditë

kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).

14. “Minimumi i shërbimeve publike” është paketa e shërbimeve publike më të domosdoshme, për të ruajtur normalitetin e funksionimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në një nga rastet e vështirësive financiare të përcaktuara në ligjin nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

15. “Menaxher i borxhit dhe detyrimeve” është personi apo njësia e miratuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, për ndjekjen e problemeve të borxhit dhe të detyrimeve të prapambetura në rastet e njësisive kur janë me probleme dhe vështirësi financiare.

16. “Mbikëqyrës financiar” është personi i emëruar nga ministria përgjegjëse për financat për menaxhimin financiar të njësisive që janë me vështirësi serioze financiare.

17. “Nëpunës autorizues” është kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ose zëvendësi i tij (nëse kryetari vendos ta delegojë këtë përgjegjësi), përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, që përgjigjet përpara nëpunësit të parë autorizues.

18. “Nëpunës zbatues” është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat në njësinë e vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

19. “Njësi të vetëqeverisjes vendore me madhësi të ngjashme” janë njësitë me madhësi të përafërta nga;

- a) numri i popullsisë;
- b) kapaciteti fiskal (potenciali fiskal); dhe
- c) sipërfaqja.

20. “Periudhë faljeje” është periudha gjatë së cilës huadhënësi i lejon huamarrësit të mos bëjë pagesat e huas apo t’i bëjë ato në mënyrë të pjesshme pa aplikuar gjopa apo penalitete.

21. “Rehabilitim financiar” është një plan veprimi, i cili përcakton të gjitha masat, afatin dhe personat përgjegjës për rikuperimin e vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

22. “Strategji e menaxhimit të pronave publike vendore” është dokumenti i miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme.

23. “Shërbime publike” janë shërbimet që sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

24. “Të ardhura korrente” janë të ardhurat që sigurohen nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike, transfertat e pakushtëzuar sektoriale, transfertat të kushtëzuara, taksat dhe tarifat vendore.

25. “Të ardhurat korrente të pakushtëzuara” janë të ardhurat korrente nga burimet e veta dhe të ardhurat korrente nga burimet kombëtare.

26. “Të ardhurat korrente nga burimet e veta” janë të ardhurat që sigurohen nga:

- a) Taksa vendore si:
 - i. taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
 - ii. taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
 - iii. taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
 - iv. taksa e tabelës;
 - v. taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
 - vi. taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, ku përfshihen taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
 - vii. Taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.
- b) Taksa të ndara si:

i. taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;

ii. taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;

iii. taksa e rentës minerare;

iv. tatimi mbi të ardhurat personale.

c) Tarifat vendore, ku përfshihen të gjitha tarifat që njësi e vetëqeverisjes vendore mbledh për kryerjen e shërbimeve publike dhe administrative.

d) Asetet dhe veprimtaritë ekonomike të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

27. “Transferta e pakushtëzuar” është transfera që jepet nga buxheti i shtetit, njësi e vetëqeverisjes vendore pa interes, pa kushte dhe pa të drejtë kthimi për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

28. “Transfertë specifike” është një formë e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që përdoret vetëm për funksionin vendor, për të cilin është dhënë dhe për rastet specifike të parashikuara në ligj

29. “Taksë vendore” është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e njësi e vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

30. “Taksë e ndarë” është taksa ku të ardhurat ndahen midis pushtetit qendror dhe njësi e vetëqeverisjes vendore.

31. “Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejtë të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

32. “Teprica operative” është diferenca midis të ardhurave korrente të pakushtëzuara me shpenzimet korrente nga këto burime.

III. PROCEDURA PËR MONITORIMIN E GJENDJES FINANCIARE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Procedura për klasifikimin mujor të njësi e vetëqeverisjes vendore, sipas nivelit të vështirësisë financiare

33. Sipas ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar paraqiten katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore (tabela 1).

Tabela 1. Rastet sipas gjendjes financiare të njësi e vetëqeverisjes vendore

Nr.	Rastet	Kriteret e klasifikimit
1	Probleme financiare (ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 55)	i. Detyrimet financiare të konstatuara dhe papaguara të NJVQV-së, përbëjnë 15 për qind të shpenzimeve vjetore faktike, në një muaj të caktuar; ii. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara të NJVQV-së, tejkalojnë 20 për qind të shpenzimeve vjetore faktike në muajin pasues.
2	Vështirësia financiare (ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 56)	Njësi e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare, kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit, kur tejkalon nivelin prej 20 për qind, dhe vlera e stokut rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 për qind të shpenzimeve vjetore faktike.
3	Vështirësia serioze financiare (ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 57)	Njësi e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare, kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore faktike.
4	Paaftësia paguese (ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 59)	Kur njësi e vetëqeverisjes vendore, nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose shumën e borxheve afatgjata të NJVQV-së dhe detyrimeve të papaguara është më e lartë se 130 për qind e shpenzimeve vjetore faktike.

34. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me degët përkatëse të thesarit brenda datës 20 të muajit pasardhës, duhet të rakordojnë të dhënat e muajit të mëparshëm mbi të ardhurat sipas llojit, shpenzimeve sipas llogarive ekonomike e burimit të financimit sipas aneksit 2, dhe detyrimeve

të prapambetura sipas aneksit 1, bashkëlidhur udhëzimit. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet t'i përdorin këto tabela për të bërë vetëvlerësimin për gjendjen e tyre financiare.

35. Në raportin e vetëvlerësimit financiar për katërmujorin e parë dhe të dytë të vitit, për vlerësimin e situatës financiare do të përdoren të dhënat e gjeneruara dhe të rakorduara me degën përkatëse të thesarit për detyrimet financiare të prapambetura dhe shpenzimet vjetore faktike të vitit paraardhës (shembull: detyrimet financiare të prapambetura për periudhën janar–prill/maj–gusht, viti t/shpenzimet vjetore faktike, viti t-1).

36. Në raportin e vetëvlerësimit financiar për katërmujorin e tretë/raporti i konsoliduar vjetor për vlerësimin e situatës financiare, do të përdoren të dhënat e gjeneruara dhe të rakorduara me degën përkatëse të thesarit për detyrimet financiare të prapambetura dhe shpenzimet vjetore faktike të vitit, për të cilin po vlerësohet gjendja financiare (shembull: detyrimet financiare të prapambetura deri në 31 dhjetor, viti t/shpenzimet vjetore faktike, viti t).

37. Nëpërmjet raportit të vetëvlerësimit, njësia e vetëqeverisjes vendore identifikon se në cilin nga rastet e vështirësisë financiare ndodhet. Ky raport do të përfshijë:

- a) tabelën e të ardhurave të NJVQV-së, shpenzimet dhe financimin për periudhën e raportimit;
- b) një tabelë me borxhin e papaguar dhe detyrimet e prapambetura ndaj palëve të treta, deri në periudhën e raportimit.

38. Si një masë e nevojshme kontrolli, regjistri i prokurimeve publike në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo rishikim i tij gjatë vitit, duhet të depozitohet zyrtarisht dhe elektronikisht në degën e thesarit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor ose për më shumë se një vit (për kontratat shumëvjeçare të investimeve).

39. Evidentimi i faktit, nëse njësia e vetëqeverisjes vendore ndodhet në njërin nga rastet e vështirësive financiare të përcaktuara në ligjin nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe në këtë udhëzim, është detyrë e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur ministria përgjegjëse për financat evidenton që një njësi e vetëqeverisjes vendore ndodhet në një nga rastet e vështirësive financiare njofton menjëherë kryetarin e njësisë.

40. Evidentimi i rasteve të ndodhjes së njësisë së vetëqeverisjes vendore në vështirësi financiare mund të bëhet nga auditimi dhe kontrolli i brendshëm, ose/dhe nga auditimi, inspektimi dhe kontrolli i jashtëm i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për rastet e konstatuara me probleme financiare dhe vështirësi financiare, duhet të njoftohet menjëherë kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe në rastet e vështirësive serioze financiare dhe të paaftësisë pagueuse njoftohet po ashtu menjëherë kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ky i fundit menjëherë njofton këshillin e NJVQV-së, si dhe ministrinë përgjegjëse për financat. Ministria përgjegjëse për financat, brenda muajit pasardhës të çdo katërmujori duhet të përgatisë një informacion përmbledhës mbi treguesit e raportit të gjendjes financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Identifikimi i rasteve të situatave të vështirësisë financiare

41. Në përputhje me të dhënat e raportit të gjendjes financiare, njësia e vetëqeverisjes vendore (nëpunësi zbatues), nëpërmjet rakordimit me degën përkatëse të thesarit, duhet të evidentojë stokun e borxhit afatgjatë dhe të detyrimeve financiare të prapambetura të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

42. Në përputhje me të dhënat e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë mbi kontratat e nënshkuara dhe të papaguara, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të evidentojë çdo muaj faturat të cilat përmbushin kriteret e klasifikimit si detyrime financiare të prapambetura. Për qëllime evidentimi, detyrimet financiare të prapambetura duhet të kategorizohen sipas:

- a) madhësisë;
- b) kohës (vonesës); dhe
- c) tipit të kreditorit;

43. Në evidentimin e situatës së vështirësisë serioze financiare dhe paaftësisë paguese, kreditë, obligacionet dhe garancitë e njësive së vetëqeverisjes vendore duhet të ndahen nga detyrimet e prapambetura.

44. Nëpunësi zbatues i njësive së vetëqeverisjes vendore që ndodhet në njërin nga situatat e vështirësive financiare, duhet të analizojë faktorët, të cilët kanë krijuar detyrimet e prapambetura, ndër të cilët mund të jenë:

- mosmbledhja e të ardhurave vendore;
- mungesa e likuiditetit etj.

45. Kryetari i njësive së vetëqeverisjes vendore, pas analizës së zhvilluar lidhur me shkaqet për pagesat e vonuara, do të miratojë masa specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e eficiencës në kryerjen e shpenzimeve.

46. Njësia e vetëqeverisjes vendore përgatit një raport lidhur me faktorët që kanë ndikuar që njësia të gjendet në njërin nga rastet e vështirësisë financiare. Një kopje e këtij raporti, pas miratimit nga kryetari i njësive, i dërgohet këshillit.

47. Njësia e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me degën përkatëse të thesarit do të monitorojë pagesat e pashlyera në të dyja rastet e para të vështirësive financiare dhe do të monitorojë pagesat e pashlyera dhe detyrimet e papaguara të borxhit në të dyja rastet e tjera (duke iu referuar SIFQ për kontrollin e faturave kundrejt fondeve buxhetore vjetore, dhe datat e pagesave kundrejt mjeteve monetare të disponueshme të njësive).

48. Të gjithë treguesit financiarë, që lidhen me detyrimet financiare të prapambetura të njësive së vetëqeverisjes vendore, duhet të vlerësohen në përputhje me treguesit e paraqitur në dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të njësive.

Tabela 2. Treguesit financiarë të detyrimeve të prapambetura

<i>Treguesi</i>	<i>Njësia raportimit</i>	<i>Koha</i>
Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara prej më shumë se 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) në përqindje të totalit të shpenzimeve vjetore faktike.	NJVQV, Thesari	Mujore
Detyrimet e prapambetura nga taksat me një vonesë më shumë se 18 muaj, në përqindje ndaj totalit të detyrimeve të prapambetura nga taksat.	NJVQV, Thesari	Katërmujore
Detyrimet e prapambetura të NJVQV-së në përqindje të totalit të të ardhurave.	NJVQV	Vjetore
Borxhi afatshkurtër në përqindje të totalit të të ardhurave të veta vendore dhe të ardhurave nga taksat e ndara.	NJVQV, Thesari	Mujore
Shërbimi vjetor i borxhit (interesi, principali, komisionet) për borxhin afatgjatë plus pagesa e palikuiduara të NJVQV-së.	NJVQV	Vjetore
Stoku i borxhit në përqindje të mesatares së të ardhurave të njësive së vetëqeverisjes vendore për 3 vjetet e fundit (taksat, tarifat, taksat e ndara, transfertat e pakushtëzuar).	NJVQV	Vjetore

49. Ministria përgjegjëse për financat, në analizën periodike të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbështetur në raportet e monitorimit të përgatitura nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, mund të konstatojë rast pas rasti nëse NJVQV-ja ndodhet në njërin prej situatave të vështirësive financiare.

50. Në rast se gjendja e vështirësisë financiare konstatohet nga ministria përgjegjëse për financat, atëherë kjo e fundit njofton njësinë e vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave.

Procedura për raportin katërmujor të vlerësimit financiar të njësive së vetëqeverisjes vendore

51. Nëpunësi zbatues i njësive së vetëqeverisjes vendore, si pjesë të raportit periodik katërmujor të monitorimit të zbatimit të buxhetit duhet të përfshijë edhe vlerësimin e përgjithshëm financiar të njësive.

52. Raporti katërmujor duhet të dërgohet në ministrinë përgjegjëse për financat në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 30.7.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të

buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, dhe formateve të aneksit 1, dhe aneksit 2, bashkëlidhur udhëzimit.

Procedura për raportin e konsoliduar vjetor të ministrisë përgjegjëse për financat mbi gjendjen financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore

53. Brenda pesë muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, ministria përgjegjëse për financat do të përgatisë një raport/apo opinion të konsoliduar të vlerësimit financiar vjetor të përgjithshëm të njërive të vetëqeverisjes vendore. Ky raport do të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat.

IV. PROCEDURAT DHE MASAT PËR RASTET E VËSHTIRËSIVE FINANCIARE TË NJËRIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Standardet dhe shërbimet publike vendore minimale që duhet të ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

54. Pavarësisht nga veprimet e ndërmarra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për rehabilitimin financiar për çdo rast të vështirësive financiare, çdo njësi duhet të jetë në gjendje të ofrojë minimumin e nevojshëm të shërbimeve publike brenda një standardi të pranueshëm. Një listë orientuese për standardet e shërbimit publike janë të përcaktuara në aneksin 3.

55. Ministria përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe përfaqësuesit e shoqatave të të zgjedhurve vendore, do të rishikojnë dhe do të përcaktojnë standardet minimale të shërbimeve publike, në përputhje me aktet ligjore/nënligjore që i përcaktojnë ato. Treguesit e performancës së shërbimeve publike duhet të jenë të kuptueshëm dhe të matshëm, në mënyrë që njësitë e vetëqeverisjes vendore të jetë në gjendje t'i përdorë ato për hartimin e planit për daljen nga situatat e vështirësive financiare.

56. Në varësi të specifikave të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore dhe sipas situatave në të cilën ndodhet, NJVQV-ja i propozon ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë së linjës përgjegjëse të zgjerojë listën e shërbimeve minimale.

57. Lista e shërbimeve, treguesit e performancës dhe standardet minimale të shërbimeve publike, duhet t'u bëhet e njohur njërive të vetëqeverisjes vendore në çdo rast të identifikuar të vështirësive financiare.

58. Në rast se standardet minimale nuk janë të përcaktuara, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të përcaktojë si standard minimal për funksionet që ushtron njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në 75 për qind të nivelit të shërbimit të ofruar në 2 vjetët e fundit.

4.1 Problemet financiare

Përkufizimi

59. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, konsiderohet me probleme financiare, kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta, dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë 15 për qind të shpenzimeve vjetore faktike.

60. Nëse në muajin pasues, totali në vlerë i detyrimeve financiare të konstatuara dhe të papaguara tejkalon nivelin prej 20 për qind të shpenzimeve vjetore faktike, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton këshillin e njësisë për arsyet e situatës së krijuar, duke identifikuar faktorët që kanë shkaktuar nivelin e lartë të detyrimeve dhe propozon masat përkatëse për daljen nga situata e problemeve financiare.

Roli dhe përgjegjësitë

61. Njësitë përgjegjëse për financën/buxhetin, duhet të përgatitë një informacion të detajuar lidhur me detyrimet financiare të prapambetura të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë edhe njësitë e veta shpenzuese, në rastin kur NJVQV-ja konstatohet me probleme financiare.

62. Kryetari i njësisë, mund të përcaktojë një punonjës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili do të jetë përgjegjës për zhvillimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe do të koordinojë zhvillimin dhe zbatimin e masave të ndërmarra.

63. Gjatë periudhës së shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore do të koordinojë zhvillimin dhe zbatimin e masave të ndërmarra, duke dërguar edhe informacion periodik këshillit të NJVQV-së.

64. Si pjesë e raportit të masave që do të ndërmerren për daljen nga gjendja e njësisë me probleme financiare, duhet të përgatitet edhe një plan implementimi dhe zbatimi, i cili i dërgohet edhe këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

65. Hartimi dhe zbatimi i masave të ndërmarra për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura duhet të jetë në përputhje me ciklin e përgatitjes dhe planifikimit të buxhetit afatmesëm në nivel vendor.

66. Masat e njësisë për rritjen e të ardhurave, shkurtimet në shpenzime duhet të hartohen me një afat kohor mujor, duke përcaktuar edhe personat përgjegjës që do të jenë pjesë e procesit. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore do të kontrollojë dhe do të monitorojë instrumentet e propozuara të menaxhimit të problemeve financiare vendore.

67. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet t'i propozojë këshillit ndryshim të planit të masave, në rast se plani i miratuar nuk është duke u realizuar sipas parashikimit.

68. Në rast se është e domosdoshme që për të dalë nga gjendja e problemeve financiare duhet të rishikohet buxheti i miratuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ia propozon këshillit. Këshilli i NJVQV-së, pasi shqyrton kërkesën e kryetarit, miraton ose jo kërkesën për rishikimin e buxhetit.

69. Nëpunësi zbatues, i dërgon kryetarit të NJVQV-së, raporte periodike monitorimi nëpërmjet të cilave siguron se pagesat kryhen sipas prioriteteve të vendosura në planin e masave për daljen e njësisë nga gjendja e problemeve financiare.

70. Në rast se nga rakordimi me degën përkatëse të thesarit, konstatohet se detyrimet financiare të prapambetura të njësisë së vetëqeverisjes vendore në gjendjen e problemeve financiare të përshkruar në këtë pjesë, janë rritur aq sa NJVQV-ja plotëson kushtet për kalimin në fazën e vështirësive financiare, atëherë kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duhet të njoftojë këshillin e njësisë për situatën në të cilën ndodhet njësia duke i paraqitur raportin e evidentimit të situatës financiare.

Masat që do të ndërmerren

71. Masat që do të ndërmerren për daljen nga situata e problemeve financiare do të jenë pjesë e buxhetit vjetor të miratuar, buxhetit të rishikuar dhe programit buxhetor afatmesëm.

72. Huat e vonuara dhe faturat e papaguara duhet të grupohen sipas:

- a) kohës (vonesës);
- b) madhësisë;
- c) riskut dhe llojit të kreditorit/furnitorit (publike, kompani, individ).

73. Radha e pagesave për secilën kategori të kreditorëve për detyrimet financiare të prapambetura do të ndjek parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar (FIFO). Pagesat do të fillojnë nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga njësia e vetëqeverisjes vendore, të dokumentacionit që vërteton kryerjen e punimeve/shërbimeve/dorëzimin e mallrave. Radha e pagesës do të ndryshojë vetëm nëse ka parregullsi në dokumentacion që kërkon verifikime të mëtejshme.

74. Procedurat e ndjekura nga njësia e vetëqeverisjes vendore për shlyerjen e detyrimeve duhet të jenë transparente, të besueshme, dhe të drejta.

75. Një nga mundësitë për pagesën e detyrimeve financiare të prapambetura është rritja e të ardhurave vendore nëpërmjet përmirësimit të mbledhjes së taksave dhe përdorimi i fondit rezervë/fondit të kontigjencës në dispozicion për uljen e detyrimeve të prapambetura.

76. Kufizimi i shpenzimeve vendore do të krijojë mundësinë e kursimeve për shlyerjen e detyrimeve në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

77. Përdorimi i aseteve vendore sipas strategjisë vendore të menaxhimit të pronës.

78. Në vitin ushtrimor dhe në vitet në vazhdim përpara se të fillojë procesi i prokurimit, duhet të sigurohet financimi i mjaftueshëm bazuar në disponueshmërinë e fondeve buxhetore për të gjitha detyrimet e marra përsipër nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

79. Për zbatimin e planit të masave për daljen nga situata e problemeve financiare, njësia e vetëqeverisjes vendore mund të negociojë me kreditorët dhe furnizuesit të cilëve u është vonuar shlyerja e detyrimeve më shumë se 60 ditë për të riorganizuar detyrimet.

80. Në këtë periudhë nuk mund të shtohen detyrime të reja deri në momentin, kur njësia e vetëqeverisjes vendore të arrijë limitin minimal të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara, sipas kushtit në të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore ndodhet në situatën e problemeve financiare.

81. Në çdo rast të veprimeve që do të ndërmerren duhet të sigurohet se njësia e vetëqeverisjes vendore është ende në gjendje të sigurojë nivelin minimal të shërbimeve publike vendore të përcaktuara në aneksin 3 të këtij udhëzimi.

Raportimi mbi gjendjen e problemeve financiare (monitorimi dhe evidencat)

82. Zbatimi i planit të masave për menaxhimin e problemeve financiare vendore i raportohet këshillit çdo muaj. Me këto raporte, këshilli duhet të miratojë veprimet e propozuara, të cilat janë nën diskrecionin e tij (p.sh., rritja e nivelit të të ardhurave, rishikimi i buxhetit, shitja/përdorimi i aseteve etj.).

83. Afati për zbatimin e planit të masave për daljen nga gjendja e problemeve financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore është deri në 12 muaj nga momenti i konstatimit të situatës.

84. Procedurat e menaxhimit të problemeve financiare duhet të ndërpriten kur gjendja e detyrimeve të prapambetura bie nën nivelin minimal të kërkuar nga ligji.

85. Raporti i fundit për këshillin e NJVQV-së, mbi zbatimin e planit të masave duhet të përfshijë të dhënat financiare, të cilat vërtetojnë rikthimin në gjendjen normale financiare të njësisë.

Tabela 3. Procedurat për menaxhimin e problemeve financiare

Nr.	Veprimet, hapat	Personi/institucioni përgjegjës	Afati
1.	Identifikimi i problemeve financiare	Kryetari i NJVQV-së, MFE	Në çdo kohë
2.	Procesi i shlyerjes së detyrimeve	Kryetari i NJVQV-së	Menjëherë
3.	Analiza mbi situatën e problemeve financiare dhe propozimet e këshillit të NJVQV-së	Kryetari i NJVQV-së	20 ditë pas identifikimit
4.	Vendimi i këshillit të NJVQV-së	Këshilli i NJVQV-së	15 ditë pas njoftimit nga kryetari i NJVQV-së
5.	Zbatimi i planit të masave	Kryetari i NJVQV-së	Vazhdimësi
6.	Raportim mbi zbatimin e planit të masave	Këshilli i NJVQV-së	Mujor
7.	Dalja nga situata e problemeve financiare	Këshilli i NJVQV-së	Brenda 12 muajve
8.	Kalimi në fazën e dytë (vështirësia financiare)	Këshilli i NJVQV-së/MFE	Pas 12 muajsh

4.2 Vështirësitë financiare

Përkufizimi

86. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 55, të ligjit 68/2017, dhe vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 për qind të shpenzimeve vjetore faktike.

Roli dhe përgjegjësitë

87. Nëpunësi zbatues i njësisë së vetëqeverisjes vendore mbështetur mbi të dhënat financiare mujore të evidentuara duhet të bëjë një analizë mbi gjendjen financiare, sipas treguesve të fazës së vështirësive financiare ku ndodhet njësia.

88. Mbështetur mbi gjendjen e evidentuar nga analiza, nëpunësi zbatues i raporton kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore situatën financiare në të cilën ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore.

89. Brenda 20 ditëve nga konstatimi, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan sipas aneksit 4, për daljen nga situata e vështirësisë financiare dhe ia dërgon këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

90. Në këtë periudhë nuk mund të shtohen detyrime të reja derisa njësia e vetëqeverisjes vendore të arrijë kufirin minimal të detyrimit të kësaj faze.

91. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrton dhe miraton planin brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij nga kryetari.

92. Një kopje e planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare të miratuar nga këshilli, i dërgohet zyrtarisht ministrisë përgjegjëse për financat, e cila mund të japë rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës së vështirësisë financiare.

93. Pas shpalljes së gjendjes së vështirësisë financiare dhe miratimit të planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare, kryetari duhet të emërojë një anëtar të personelit ose të ngrejë një njësi në administratën e NJVQV-së, i cili/e cila do të jetë përgjegjës/e për zbatimin e planit për daljen nga gjendja e vështirësisë financiare.

94. Njësia përgjegjëse do të koordinojë zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe, gjithashtu, i raporton direkt kryetarit të NJVQV-së. Kjo njësi në mënyrë periodike mujore duhet të hartojë raporte dhe evidenca mbi ecurinë e implementimit të planit të miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

95. Njësia përgjegjëse është e autorizuar të mbledhë informacion nga administrata e njësisë nëpërmjet procedurave zyrtare të raportimit mbi detyrimet e prapambetura. Kjo njësi ka të drejtë të koordinojë punën brenda administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore/njësisë shpenzuese për të zhvilluar planin e daljes nga gjendja e vështirësisë financiare.

96. Njësia përgjegjëse mund të negociojë me kreditorët për të rishikuar planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Marrëveshjet me kreditorët duhet të miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

97. Kur hartimi dhe zbatimi i planit të rehabilitimit përkon me ciklin e planifikimit të buxhetit, njësia përgjegjëse për zbatimin e këtij plani është e përfshirë në planifikimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor si këshilltar i kryetarit të NJVQV-së.

98. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, informohet për zbatimin e planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare çdo muaj nga kryetari i NJVQV-së.

99. Ministria përgjegjëse për financat, pas shpalljes së gjendjes së vështirësisë financiare nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në mënyrë periodike, sipas të dhënave të raportuara, por edhe të identifikuara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, monitoron ecurinë e zbatimit të planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare dhe ecurinë financiare të NJVQV-së.

100. Në rast se nga rakordimi me degën e thesarit, konstatohet që detyrimet financiare të prapambetura të njësisë së vetëqeverisjes, edhe pse nën regjimin e gjendjes së vështirësisë financiare të përshkruar në këtë kapitull janë rritur, duke plotësuar kushtet për kalimin në fazën e vështirësive serioze, atëherë kryetari, së bashku me raportin e evidentimit, duhet të njoftojë këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

101. Procesi i menaxhimit të NJVQV-ve në vështirësi financiare fillon kur kryetari i NJVQV-së dorëzon planin e daljes nga gjendja e vështirësisë financiare në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

102. Pas miratimit të planit, kryetari i NJVQV-së informon ministrinë përgjegjëse për financat për planin e masave që do të ndërmerren për zgjidhjen e situatës së vështirësisë financiare.

103. Nëse këshilli nuk është në gjendje të miratojë planin brenda kësaj periudhe kohore, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton ministrinë përgjegjëse për financat.

104. Raportet periodike mbi zbatimin e planit duhet t'i dorëzohen këshillit të NJVQV-së çdo muaj dhe të sigurohet transparenca e procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

105. Bazuar në këto raporte, këshilli duhet të miratojë planin e propozuar, nën diskrecionin e tij (p.sh., rishikimi i të ardhurave të NJVQV-së, rishikimi i shpenzimeve të planifikuara, të ardhura nga shitja/përdorimi i aseteve).

Plani dhe masat që do të ndërmerren

106. Plani për daljen nga situata e vështirësisë financiare duhet të jetë në përputhje me planin e buxhetit vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm të miratuar, duke marrë në konsideratë trendet në dy vitet e fundit të periudhës së parashikuar të buxhetimit.

107. Për hartimin e planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare, masat që do të ndërmerren duhet të synojnë:

- i. rritjen e të ardhurave vendore dhe përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë;
- ii. rishikimin e shpenzimeve buxhetore; dhe
- iii. përdorimin e të ardhurave nga shitja/përdorimi i aseteve.

108. Niveli i përdorimit të limitit të fondit Rezervë dhe Kontigjencës trajtohet sipas rastit nga këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore. Në rast se situata e vështirësisë financiare konstatohet në fund të periudhës buxhetore, atëherë përdorimi mund të jetë i plotë, në rastin kur situata konstatohet gjatë vitit atëherë duhet të realizohet një vlerësim për ngjarjet që mund të paraqiten. Këshilli i NJVQV-së vendos se në cilën masë do të përdoret fondi rezervë dhe i kontigjencës.

109. Një mënyrë tjetër për shtimin e të ardhurave është kredia afatshkurtër, e cila mund të përdoret, gjithashtu, për rir financimin e detyrimeve të prapambetura më urgjente.

110. Pavarësisht veprimeve të propozuara, NJVQV-të duhet të jenë në gjendje të garantojnë aksesin në shërbimet themelore të përcaktuara me ligj dhe t'i sigurojnë ato në nivelin minimal për të gjithë qytetarët (aneksi 3 i këtij udhëzimi).

111. Plani për daljen nga gjendja e vështirësisë financiare i përgatitur nga kryetari i NJVQV-së, për këshillin duhet të përmbajë një plan specifik zbatimi. Masat për rritjen e të ardhurave, shkurtimeve e shpenzimeve dhe mundësia potenciale e aseteve në dispozicion duhet të ndiqen periodikisht nga personat përgjegjës, me qëllim që këshilli të jetë në gjendje të kontrollojë dhe të monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës së vështirësive financiare të NJVQV-së.

112. Plani i miratuar për daljen nga gjendja e vështirësisë financiare duhet të dërgohet në ministrinë përgjegjëse për financat. Ministria përgjegjëse për financat mund të bëjë komente/rekomandime të mëtejshme se si të menaxhohet situata e vështirësisë financiare.

113. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duhet t'u përgjigjen këtyre propozimeve ose duke i diskutuar ato me ministrinë përgjegjëse për financat ose duke përfshirë rekomandimet në planin e rishikuar.

114. NJVQV-të mund të vendosin mbi hapat dhe kushtet për zgjidhjen e rasteve nëpërmjet negociatave brenda të gjitha grupeve të kreditorëve.

115. Procedurat për negociatat me kreditorët apo furnizuesit për veprimet e mundshme që mund të ndërmerren për zbatimin e planit, duhet të miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

116. Për sa përcaktohet në pikën e mësipërme, kryetari në emër të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duhet të ftojë të gjithë kreditorët për të negociuar mbi detyrimet e prapambetura.

117. Në rastin e një numri të madh të kreditorëve me pretendime relativisht të vogla, një përfaqësues i përzgjedhur i tyre mund të negociojë për grupin më të madh. Në negociata do të marrin pjesë vetëm ata kreditor që ju është vonuar pagesa më shumë se 60 ditë kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).

118. Qëllimi i këtyre negociatave është shpërndarja e pagesave të kësteve midis kreditorëve, sipas një plani të rishikuar në përputhje me mundësitë financiare të disponueshme nga njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve bazë për qytetarët.

119. Menaxheri i borxhit dhe i detyrimeve që udhëheq këto negociata duhet të bjerë dakord me shkrim me të gjitha palët brenda afatit të caktuar. Marrëveshjet do të miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Raportimi mbi gjendjen e vështirësisë financiare

120. Raporti i fundit për këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore mbi zbatimin e planit të masave duhet të përfshijë të dhënat financiare, të cilat vërtetojnë rikthimin në gjendjen normale financiare të njësisë.

121. Afati për zbatimin e planit të masave për daljen nga gjendja e vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore është deri në 12 muaj nga data e konstatimit të situatës.

122. Nëse NJVQV-ja nuk është në gjendje të arrijë këtë nivel minimal të detyrimeve të prapambetura brenda 12 muajve, atëherë ndiqen (kalohet) automatikisht në procedurat për vështirësitë serioze financiare.

Dalja nga gjendja e vështirësisë financiare

123. Procedurat e vështirësisë financiare duhet të ndërpriten kur stoku i detyrimeve të prapambetura bie nën nivelin e treguesit financiarë të kërkuar nga ligji për financat e vetëqeverisjes vendore, për vështirësitë financiare.

Tabela 4. Procedurat për trajtimin e vështirësive financiare

Nr.	Veprimet, hapat	Personi/institucioni përgjegjës	Afatet
1	Inicimi i procesit për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura	Kryetari i NJVQV-së, MFE	Në çdo kohë
2	Përgatitja e planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare dërgon në këshill, emërimi i njësisë përgjegjëse	Kryetari i NJVQV-së	20 ditë pas identifikimit të vështirësisë financiare
3	Vendimi i këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore (për miratimin e planit), informimi i MFE-së	Këshilli i NJVQV-së	15 ditë, pas paraqitjes së planit
4	Komentet dhe rekomandimet e MFE-së	MFE	Brenda 10 ditëve nga miratimi i planit
5	Rishikimi i planit të daljes nga gjendja e vështirësisë financiare	Këshilli i NJVQV-së	Brenda 5 ditëve të komenteve të MFE-së
6	Procesi i implementimit	Kryetari i NJVQV-së/Menaxheri i Borxhit	Në vazhdim
7	Raportimi mbi zbatimin e planit	Këshilli i NJVQV-së	Mujore
8	Ndërprerja (detyrimet e prapambetura nën limitin e përcaktuar në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore)	Këshilli i NJVQV-së	Brenda 12 muajve
9	Ndërprerja duke shkuar në kategorinë 3 (vështirësi serioze financiare)	Këshilli i NJVQV-së/MFE	Pas 12 muajve

4.3 Vështirësitë serioze financiare

Përkufizimi

124. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare, kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore faktike.

Roli dhe përgjegjësitë

125. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore në rolin e nëpunësit autorizues, me konstatimin e situatës së vështirësisë serioze financiare, njofton menjëherë këshillin e njësisë dhe ministrinë përgjegjëse për financat.

126. Ministria përgjegjëse për financat, me marrjen e njoftimit nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë Këshillin e Ministrave, ose kur e konstaton vetë njofton menjëherë kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Këshillin e Ministrave.

127. Këshilli i Ministrave, me marrjen e njoftimit dhe masave të propozuara për menaxhimin e situatës së vështirësisë serioze financiare nga ministria përgjegjëse për financat, vendos të:

a) Japë mbështetje financiare në formën e ndihmës apo huas, duke përcaktuar edhe planin për daljen e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga situata e vështirësisë serioze financiare, si dhe planin e kthimit të shumës së dhënë;

b) Mandatojë ministrinë përgjegjëse për financat për të negociuar ristrukturimin e borxheve dhe të detyrimeve financiare të prapambetura;

c) Shpallë njësinë e vetëqeverisjes vendore në mbikëqyrje financiare dhe të autorizojë ministrinë përgjegjëse për financat si mbikëqyrës financiar të saj, duke respektuar rigorozisht këto kushte:

i) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të marrë asnjë vendim që mund të çojë në shtimin e detyrimeve të saj financiare;

j) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër;

k) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të shlyejë asnjë detyrim financiar, të krijuar para shpalljes së rastit të vështirësisë financiare, përveç detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit financiar.

128. Ministria përgjegjëse për financat, informon njësinë e vetëqeverisjes vendore, në rast se është parashikuar ndihmë financiare nga qeveria qendrore për daljen nga gjendja e vështirësisë serioze financiare.

129. Këshilli i njësisë miraton kërkesën e njësisë së vetëqeverisjes vendore për ndihmë financiare nga qeveria qendrore.

130. Këshilli i njësisë miraton marrëveshjet për mënyrën e shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura midis njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kreditorëve, pas përfundimit të procesit të negociimit të udhëhequr prej mbikëqyrësit financiar dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor.

131. Kryetari i njësisë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave përgatit planin e rehabilitimit financiar, me asistencën e ministrisë përgjegjëse për financat, dhe e paraqet për miratim në këshillin e NJVQV-së.

132. Në rastin kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk e dorëzon këtë plan brenda 30 ditëve nga shpallja e njësisë në mbikëqyrje financiare, ministria përgjegjëse për financat përgatit planin e rehabilitimit financiar.

133. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda 30 ditëve nga shpallja e njësisë në mbikëqyrje financiare, miraton planin e rehabilitimit financiar, të cilin e dërgon për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat.

134. Ministria përgjegjëse për financat mund të autorizojë mbikëqyrësin financiar për të kufizuar kompetencat vendimmarrëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore në vështirësi serioze financiare.

135. Mbikëqyrësi financiar, i përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financat, ka të drejtë të:

a) ndihmojë njësinë e vetëqeverisjes vendore në zhvillimin e planit të rehabilitimit financiar dhe të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani;

b) menaxhojë administratën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në lidhje me veprimet e përcaktuara në planin e rehabilitimit financiar;

c) mbledhë informacion nga njësia e vetëqeverisjes vendore për detyrimet e papaguara ndaj të tretëve;

d) japë urdhra brenda administratës vendore, njësisë të varësisë ose entiteteve të jashtme publike për zbatimin e planit të rehabilitimit financiar;

e) kryesojë negociatat me kreditorët dhe furnitorët për ristrukturimin e borxhit dhe riorganizimin e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, me pjesëmarrje edhe të përfaqësuesve të pushtetit vendor;

f) përfshihet në përgatitjen e buxhetit, kur hartimi dhe zbatimi i planit të rehabilitimit financiar përkon me ciklin e planifikimit të buxhetit;

g) punojë si ndërmjetës në njësinë e vetëqeverisjes vendore në aplikimin për ndihmë financiare;

h) shqyrtojë raportin mbi zbatimin e planit të rehabilitimit financiar, përpara se të dorëzohet në këshillin e NJVQV-së dhe në ministrinë përgjegjëse për financat.

136. Me propozimin e ministrisë përgjegjëse për financat, Këshilli i Ministrave shpall se njësia e vetëqeverisjes vendore pushon së qeni subjekt i masave të vendosura, në rast se:

a) nuk rezulton me detyrime të papaguara ndaj të tretëve për dy vite të njëpasnjëshme;

b) njësia e vetëqeverisjes vendore bën kërkesë për çlirim nga këto masa dhe ministria përgjegjëse për financat vlerëson se njësia e vetëqeverisjes vendore ka ndërmarrë masa, përmes së cilave mund të

përmirësohet gjendja financiare dhe të eliminohen kushtet që kanë shkaktuar rastin e vështirësisë serioze financiare.

Plani dhe masat që do të ndërmerren

Analizimi i situatës

137. Nëpunësi zbatues i njësisë së vetëqeverisjes vendore me vështirësi serioze financiare, duhet të analizojë faktorët të cilët kanë krijuar detyrimet e prapambetura dhe borxhin afatgjatë, ndër të cilët mund të jenë: mosmbledhja e të ardhurave vendore, mungesa e likuiditetit, shpenzime nga faktorë të tjerë të jashtëm, investime të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve publike minimale etj.

138. Kryetari i njësisë përgatit një raport lidhur me faktorët që kanë ndikuar në gjendjen e vështirësisë serioze financiare, i cili miratohet nga këshilli i NJVQV-së dhe dorëzohet në ministrinë përgjegjëse për financat.

139. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas analizës së zhvilluar lidhur me shkaqet për pagesat e vonuara dhe situatën e borxhit afatgjatë, me asistencë të ministrisë përgjegjëse për financat përgatit planin e rehabilitimit financiar. Veprimet që do të ndërmerren për menaxhimin e situatës së vështirësisë serioze financiare do të jenë në drejtim të rritjes së të ardhurave nga burimet e veta, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, rishikimin e shpenzimeve buxhetore, shitjen/përdorimin e asetëve publike, ristrukturimin e borxhit dhe negociatat me kreditorët për shlyerjen e pagesave më urgjente.

Plani i rehabilitimit financiar

140. Plani i rehabilitimit financiar duhet të synojë katër alternativa bazë, të cilat duhet të përqendrohen në:

- i. rritjen e të ardhurave nga burimet e veta;
- ii. përdorimin e fondit rezervë/kontigjencës;
- iii. rishikimin e shpenzimeve buxhetore;
- iv. shitjen ose përdorimin e asetëve publike për rritjen e të ardhurave.

141. Negocimi me kreditorët apo furnitorët për ristrukturimin e pagesave është pjesë e planit të rehabilitimit financiar.

142. Për hartimin e planit të rehabilitimit financiar, detyrimet e papaguara ndaj të tretëve duhet të klasifikohen sipas llojit dhe madhësisë. Vlera e borxhit dhe detyrimeve të prapambetura do të pasqyrohet në planin e rehabilitimit financiar, sipas kriterëve për klasifikimin e tyre.

143. Hartimi dhe zbatimi i planit të rehabilitimit financiar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duhet të jetë në përputhje me ciklin e përgatitjes dhe planifikimit të buxhetit vendor.

Klasifikimi i borxhit dhe detyrimeve të prapambetura në planin e rehabilitimit financiar

144. Borxhi dhe detyrimet e prapambetura do të klasifikohen, sipas llojit karakteristikave dhe madhësisë. Kreditë, obligacionet dhe garancitë vendore të pretenduara do të ndahen nga detyrimet e tjera financiare. Detyrimet e tjera financiare, faturat e papaguara ndaj të tretëve të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve do të grupohen sipas madhësisë, kohës (vonesës) dhe llojit të furnitorit.

145. Për hartimin e masave më të përshtatshme dhe strategjinë e bisedimeve me kreditorët detyrimet e papaguara ndaj të tretëve mund të grupohen sipas prioriteve.

a) Detyrimet ndaj pushtetit qendror (p.sh. taksat, penaltitetet etj.), pagat e punonjësve kanë përparësi ndaj detyrimeve të tjera të prapambetura.

b) Evidentimi i burimit të borxhit dhe detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve është i domosdoshëm, pasi disa prej këtyre detyrimeve mund të jenë jashtë kontrollit të pushtetit vendor, kështu që ka hapësirë të kufizuar për negociata (p.sh. fondet e kushtëzuara të vonuara).

c) Për të përcaktuar se cilat detyrime do të kenë përparësi për t'u shlyer duhen mbajtur parasysht edhe risqet e borxheve, si: norma e interesit, luhatshmëria e kursit të këmbimit etj.

d) Afati i maturimit të borxhit është një tregues tjetër për të vendosur si prioritet shlyerjen e borxhit afatshkurtër kundrejt atij afatgjatë.

e) Madhësia dhe forma e kolateralit mund të ndikojë, gjithashtu, në politikat e pagesave, p.sh. pagesat e detyrimeve mund të negocohen nëpërmjet bllokimit të pasurive të paluajtshme (aseteve publike), si pasojë e mungesës së likuidimit me para (*cash*) nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Pala kreditore mund të vendosë kolateralin në shitje për arkëtimin e të ardhurave.

146. Identifikimi i burimit të borxhit dhe detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta do të jetë pjesë e planit të rehabilitimit financiar.

Zbatimi i planit të rehabilitimit financiar

147. Plani i rehabilitimit financiar mund të ndikojë në rishikimin e kuadrit fiskal, duke propozuar ristrukturim të borxhit dhe detyrimeve për daljen nga gjendja e vështirësisë serioze financiare.

148. Për menaxhimin e situatës së vështirësisë serioze financiare, njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ndër marrë këto veprime për rehabilitim financiar:

a) Rritja e të ardhurave nga burimet e veta. Brenda afatit kohor të propozuar në planin e rehabilitimit, të ardhurat korrente mund të rriten duke rritur normën tatimore, duke zgjeruar bazën tatimore dhe duke përmirësuar mbledhjen e taksave nëpërmjet një administrimi më të mirë.

b) Qiratë, tarifat dhe të ardhurat e tjera jotatimore mund të kontribuojnë, gjithashtu, në tepricën operative brenda periudhës së planifikimit. Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të autorizuara të vendosin për normat e taksave, njësia në vështirësi serioze financiare do të vendosë këto taksa të paktën sa norma mesatare e taksës së njësisë së vetëqeverisjes vendore me madhësi të ngjashme me të.

c) Me miratim nga këshilli, njësia e vetëqeverisjes vendore mund të përdorë fondin rezervë ose të kontigjencës të miratuar në buxhetin vjetor. Vlera (shuma) e përdorimit të këtyre fondeve do të përcaktohet në varësi të periudhës në të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore shpallet në vështirësi serioze financiare. Nëse njësia shpallet në vështirësi serioze financiare në muajin dhjetor të vitit buxhetor, këshilli i njësisë mund të miratojë përdorimin e të gjithë fondit rezervë dhe të kontigjencës për zgjidhjen e situatës. Në rastin kur situata konstatohet gjatë vitit atëherë duhet të realizohet një vlerësim për ngjarjet që mund të paraqiten për periudhën e ngelur.

d) Riorganizimi për pagesat në kohë të detyrimeve të prapambetura mund të krijojë fonde për pagesën e interesit ose faturat më urgjente nga furnitorët.

e) Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për kredi afatshkurtër, e cila mund të përdoret për financimin e faturave më urgjente të papaguara ndaj të tretëve ose shlyerjen e borxhit me kushte më pak të favorshme.

f) Sipas kuadrit ligjor në fuqi për pasuritë e paluajtshme të njësisive të vetëqeverisjes vendore, vetëm pasuritë jopublike me status juridik të pronës private mund të përdoren si kolateral. Për këtë grup të pasurive të paluajtshme, shitja e asetëve duhet të bëhet në përputhje me strategjinë e menaxhimit të pronës publike. Miratimi i këshillit të njësisë është i nevojshëm për klasifikimin e kolateralit si pasuri që mund të shitet sipas strategjisë së miratuar.

g) Me propozimin e mbikëqyrësit financiar, këshilli propozon planin e veprimeve të cilat janë nën diskrecionin e tij (p.sh. rishikimi i të ardhurave, rishikimi i shpenzimeve, shitja e pasurive etj.).

h) Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe kreditorët mund të lidhin marrëveshje nëpërmjet procesit të negociimit të udhëhequr nga mbikëqyrësi financiar dhe përfaqësues të pushtetit vendor, për shpërndarjen e faturave të papaguara, kësteve të ristrukturuara dhe asetëve të ndara të disponueshme. Në procesin e negociatave do të marrin pjesë vetëm furnitorët pagesat ndaj të cilëve janë vonuar më shumë se 60 ditë kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).

Raportimi mbi gjendjen e vështirësisë serioze financiare

149. Zbatimi i planit të rehabilitimit financiar është i detyrueshëm për njësinë e vetëqeverisjes vendore, e cila dorëzon të paktën një herë në 30 ditë, ose sa herë që kërkohet nga këshilli i njësisë, ose ministria përgjegjëse për financat, raporte të hollësishme për realizimin e masave, sipas këtij plani.

150. Raportet e rregullta për zbatimin e planit të rehabilitimit financiar duhet t'i dorëzohen këshillit të NJVQV-së.

151. Vendimet e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave lidhur me menaxhimin e vështirësisë serioze financiare, dhe plani i rehabilitimit financiar publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore çdo katër muaj.

Dalja nga gjendja e vështirësisë serioze financiare

152. Planit i rehabilitimit financiar dhe koha e mundshme për rikuperimin financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore me vështirësi serioze financiare është 2 vjet. Në këtë periudhë nëpërmjet planit të rehabilitimit dhe dokumenteve të tjerë, njësia e vetëqeverisjes vendore me vështirësi serioze financiare mund të ndër marrë iniciativën për të bërë reforma strukturore.

153. Procedura e ndjekur në situatën e vështirësisë serioze financiare ndërpritet me kërkesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore në mbikëqyrje financiare. Ministria përgjegjëse për financat vlerëson nëse njësia e vetëqeverisjes vendore ka marrë masat e duhura për përmirësimin e gjendjes së saj financiare dhe eliminimin e kushteve që kanë shkaktuar rastin e vështirësisë serioze financiare.

154. Me propozimin e ministrisë përgjegjëse për financat, Këshilli i Ministrave shpall se njësia e vetëqeverisjes vendore pushon së ekzistuari subjekt i masave, sipas nenit 57, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2018, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në rast se:

a) nuk rezulton me detyrime të papaguara ndaj të tretëve për dy vite të njëpasnjëshme;

b) bën kërkesë për çlirim nga këto masa dhe ministria përgjegjëse për financat vlerëson se njësia e vetëqeverisjes vendore ka ndër marrë masat e nevojshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare.

155. Nëse njësia e vetëqeverisjes vendore ndodhet në mbikëqyrje financiare për më shumë se dy vite, atëherë njësia do të shpallet automatikisht në gjendjen e paaftësisë paguese dhe procedurat për menaxhimin e gjendjes së paaftësisë paguese duhet të fillojnë detyrimisht dhe menjëherë.

Tabela 5. Procedurat për trajtimin e vështirësisë serioze financiare

Nr.	Hapat	Personi/institucioni përgjegjës	Afati
1	Fillimi i procesit të zgjidhjes së situatës së vështirësisë serioze financiare	MFE, kryetari i NJVQV-së	Në çdo kohë
2	Vendosja në mbikëqyrje financiare e NJVQV-së	Këshilli i Ministrave	15 ditë pas marrjes së njoftimit
3	Planit i rehabilitimit financiar miratuar nga këshilli i NJVQV-së	Këshilli i NJVQV-së	30 ditë nga shpallja e njësisë në mbikëqyrje financiare
4	Planit i rehabilitimit financiar aprovuar nga MFE	MFE	10 ditë pas miratimit nga këshilli i NJVQV-së
5	Kërkesa e NJVQV-së për ndihmë financiare	Këshilli NJVQV-së, MFE	Pas shpalljes së gjendjes dhe miratimit të planit
7	Zbatimi i planit të rehabilitimit financiar	Mbikëqyrësi financiar	I vazhdueshëm
8	Raportimi për zbatimin e planit MFE-së dhe këshillit të NJVQV-së	Këshilli i NJVQV-së, MFE	Çdo 30 ditë
9	Ulja e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve për dy vite të njëpasnjëshme	Këshilli i NJVQV-së	Pas 2 vitesh
10	Dalja nga gjendja e vështirësisë serioze financiare	MFE	15 ditë nga marrja e kërkesës

4.4 Paaftësia paguese

Përkufizimi

156. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në situatën e paaftësisë paguese nëse nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose nëse raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara është mbi 130 për qind e shpenzimeve vjetore faktike.

157. Njësia e vetëqeverisjes vendore që ndodhet në këtë situatë do të funksionojë nën administrimin e kontrolluar dhe duhet të zbatojë planin e veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese të përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Roli dhe përgjegjësitë

158. Konstatimi i rastit të paaftësisë paguese bëhet nga nëpunësi autorizues nëpërmjet: analizave, vetëvlerësimit, auditit dhe kontrollit të brendshëm, auditit të jashtëm ose nga ministria përgjegjëse për financat.

159. Në çdo rast (përveç rastit kur kjo konstatohet nga ministria përgjegjëse për financat), kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me konstatimin e situatës së paaftësisë paguese, njofton menjëherë këshillin e njësisë dhe ministrinë përgjegjëse për financat.

160. Me marrjen e njoftimit nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose nga ministria përgjegjëse për financat mbi gjendjen e paaftësisë paguese të njësisë, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore mbledhet në mënyrë urgjente dhe merr në shqyrtim gjendjen e krijuar, duke analizuar shkaqet dhe përgjegjësitë e krijimit të kësaj situatë. Pas mbledhjes së këshillit të NJVQV-së, hartohet një raport dhe i dërgohet ministrisë përgjegjëse për financat.

161. Ministria përgjegjëse për financat i propozon Këshillit të Ministrave vendosjen e njësisë së vetëqeverisjes vendore me paaftësi paguese nën administrim dhe emërimin e një administratori. Këshilli i Ministrave vendos emërimin e administratorit dhe shpalljen nën administrim të NJVQV-së.

162. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me administratorin dhe ministrinë përgjegjëse për financat për përgatitjen e planit të veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese dhe afatin e zbatimit të tij.

163. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me administratorin dhe ministrinë përgjegjëse për financat për përcaktimin e listës dhe të standardeve të shërbimeve publike minimale, që ofron njësia e vetëqeverisjes vendore gjatë kohës që do të jetë në situatën e paaftësisë paguese.

164. Plani i veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese, i cili do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duhet të përfshihet në programin buxhetor afatmesëm dhe automatikisht në buxhetin vjetor të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

165. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në miratimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA-së) dhe buxhetin vjetor duhet të përfshijë detyrimisht planin e veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese.

166. Rolit dhe përgjegjësi të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në udhëzimin nr. 23, datë 30.7.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore", i shtohet edhe përgjegjësia e përfshirjes së planit të veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese të njësisë së vetëqeverisjes vendore në programin buxhetor afatmesëm (PBA) dhe në buxhetin vjetor.

167. Në vendimin e Këshillit të Ministrave duhet të përcaktohet që njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të:

- a) marrë asnjë vendim që mund të çojë në shtimin e detyrimeve të saj financiare;
- b) vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër;
- c) shlyejë asnjë detyrim financiar, përveç detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në planin e veprimit.

168. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore harton një plan masash për zbatimin e planit të veprimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave, të cilin e dërgon në këshillin e NJVQV-së dhe ministrinë përgjegjëse për financat për miratim për rikthimin e njësisë në situatën normale të funksionimit. Në këtë plan duhet të rikthehet ushtrimi normal i funksioneve dhe i kompetencave të përcaktuar me ligjin e vetëqeverisjes vendore dhe akteve të tjera ligjore, si dhe miratimi i buxhetit për funksionimin normal të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

169. Afati i rikuperimit financiar dhe rikthimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në gjendjen normale është 2 vjet. Në planin e veprimit, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të ndërmarrë iniciativën e bërjes së reformave strukturore, me qëllim që rikuperimi financiar dhe shëndeti financiar të jetë i qëndrueshëm dhe afatgjatë.

170. Administratori përgatit raporte mbi zbatimin e planit të veprimit çdo muaj, të cilat ia dërgon Këshillit të njësisë dhe ministrisë përgjegjëse për financat.

171. Për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore harton një raport për gjendjen financiare të njësisë së marrë në administrim dhe ia dërgon për miratim ministrisë përgjegjëse për financat.

172. Pas shqyrtimit të raportit, por jo më vonë se 30 ditë nga marrja e tij, ministri përgjegjës për financat i propozon Këshillit të Ministrave daljen nga paaftësia paguese të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kthimin e saj në funksionimin normal.

173. Me propozimin e ministrisë përgjegjëse për financat, Këshilli i Ministrave shpall se njësia e vetëqeverisjes vendore pushon së qeni në gjendjen e paaftësisë paguese dhe kthimin në normalitet, në rast se:

- a) nuk rezulton me detyrime të papaguara ndaj të tretëve për dy vite të njëpasnjëshme;
- b) kur vërtetohet se ajo është në gjendje të shlyej pa vonesa të gjitha detyrimet e papaguara ndaj të tretëve.

174. Vendimi i Këshillit të Ministrave për vendosjen e njësisë nën administrim dhe plani i veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë duhet të bëhen publike dhe në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Administratori

175. Ministria përgjegjëse për financat i propozon Këshillit të Ministrave administratorin mbështetur në kriteret e mëposhtme:

- a) Arsimi;
- b) Eksperienca në punë;
- c) Njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

176. Procedura e përzgjedhjes së administratorëve

a) Ministri përgjegjës për financat, shpall thirrjen për administratorë, nëpërmjet një urdhri për fillimin e procesit të aplikimit dhe shpalljen e kriterëve të përzgjedhjes, për administratorë të njësisë së vetëqeverisjes vendore (NJVQV-ve që mund të jenë në kushtet paaftësisë paguese). Në këtë urdhër përcaktohen:

- i. kriteret për aplikantët;
- ii. afati i aplikimit;
- iii. mënyra e aplikimit;
- iv. mënyra e publikimit.

b) Pas mbylljes së periudhës së aplikimit për administratorë, ministri përgjegjës për financat urdhëron ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e administratorëve të njësisë së vetëqeverisjes vendore që mund të jenë në kushtet e paaftësisë paguese, për kandidatët që kanë aplikuar.

c) Komisioni do të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët dhe do të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

d) Në përfundim të këtyre etapave, ministri përgjegjës për financat nxjerr urdhrin për miratimin e listës së administratorëve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, që mund të jenë në kushtet e paaftësisë paguese.

e) Afati i vlefshmërisë së listës me kandidatët e përzgjedhur përcaktohet në urdhrin e ministrit përgjegjës për financat.

177. Këshilli i Ministrave vendos administratorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, bazuar në listën e miratuar nga ministria përgjegjëse për financat dhe përcakton rolin, detyrat dhe kompetencat e tij, si dhe mbulimin e efekteve financiare të tij.

178. Administratori i përzgjedhur duhet të deklarojë kontaktet personale, marrëdhëniet e biznesit ose ndonjë konflikt të mundshëm interesi me njësinë e vetëqeverisjes vendore.

179. Administratori është përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e të gjithë procesit të shlyerjes së borxhit dhe detyrimeve financiare të prapambetura.

180. Gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të rehabilitimit financiar, administratori, bashkë me kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ka autoritetin të marrë të gjitha vendimet (masat) lidhur me shlyerjen e borxheve.

181. Administratori udhëheq negociatat me kreditorët. Ai ka kompetenca për të vendosur mbi hapat dhe kushtet për zgjidhjen e çështjeve brenda të gjitha grupeve të kreditorëve. Për menaxhimin e situatës së paaftësisë paguese, administratori duhet të ftojë të gjithë kreditorët që të negociojnë detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta. Përfaqësuesit e pushtetit vendor, gjithashtu, do të marrin pjesë në këto negociata.

182. Administratori do të kontrollojë të gjitha angazhimet; do të nënshkruajë urdhërpagesat; do të mbikëqyrë mbledhjen e të ardhurave të veta dhe menaxhimin e aseteve të NJVQV-së. Ai/ajo raporton për zbatimin e planit të veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese në ministrinë përgjegjëse për financat dhe informon këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Administratori raporton direkt në ministrinë përgjegjëse për financat.

Plani i veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese

183. Procedurat e menaxhimit të paaftësisë paguese synojnë:

a) të sigurojnë që të gjithë kreditorët dhe furnitorët të kompensohen për borxhet/detyrimet, shërbimet dhe mallra të ofruara;

b) të garantojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e njësisë së vetëqeverisjes vendore në terma afatgjatë.

184. Plani i veprimit hartohet në përputhje me Planin Strategjik për Zhvillim të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe programin buxhetor afatmesëm të miratuar. Ky plan duhet të synojë katër alternativa bazë, të cilat duhet të përqendrohen në:

i. rritjen e të ardhurave nga burimet e veta;

ii. përdorimin e fondit rezervë/kontigjencës;

iii. rishikimin e shpenzimeve buxhetore;

iv. shitjen ose përdorimin e aseteve publike për rritjen e të ardhurave.

185. Plani i përgatitur nga administratori duhet të jetë një plan zbatimi specifik. Veprimet për rritjen e të ardhurave të veta, shkurtimeve dhe mundësia potenciale e përdorimit të aseteve duhet të parashikohen me një afat kohor mujor, si dhe të përcaktohen personat përgjegjës për zbatimin e planit.

186. Kriteri parësor i monitorimit dhe i vlerësimit nga administratori është niveli aktual i detyrimeve të papaguara me vonesa më shumë se 60 ditë kalendrike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).

187. Në hartimin e planit të veprimit për detyrimet e prapambetura, detyrimet duhet të klasifikohen sipas llojit dhe madhësisë së tyre.

188. Negocimi me kreditorët apo me furnitorët për ristrukturimin e pagesave duhet të jetë pjesë e planit të veprimit për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese.

189. Në rastin e një numri të madh të furnitorëve me pretendime relativisht të vogla, një përfaqësues i zgjedhur i tyre mund të negociojë. Do të marrin pjesë në negociata vetëm ata kreditor, të cilëve iu është vonuar pagesa më shumë se 60 ditë kalendrike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).

190. Qëllimi i këtyre negociatave është të alokojë pagesat, këstet e riprogramuara dhe pjesën e disponueshme të aseteve vendore për t'u shpërndarë midis kreditorëve, por, në të njëjtën kohë për të siguruar edhe ofrimin e shërbimeve bazë vendore. Administratori që udhëheq këto negociata duhet të bjerë dakord me shkrim me të gjitha palët brenda afatit të caktuar. Këshilli i NJVQV-së do të informohet për këto marrëveshje të negociuara.

191. Vlerësimi i stabilitetit financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të analizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Analiza do të përqendrohet në

sasinë e fondeve në dispozicion, transfertave, subvencionet e investimeve dhe dividendët e marrë, si dhe përbërjen e shpenzimeve kapitale.

Zbatimi i planit

192. Njësia e vetëqeverisjes vendore në paaftësi paguese ka të drejtë dhe mund të marrë ndihmë financiare nga qeveria qendrore. Mbështetja financiare e qeverisë qendrore mund të jepet në forma të ndryshme, si:

- i. transferta specifike;
- ii. ndihmë;
- iii. kredi me kushte etj.

193. Kushtet dhe rregullat e shpërndarjes së këtyre fondeve potenciale të buxhetit qendror duhet të jenë të mundshme për t'u përfituar nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore që ndodhen në situatën e paaftësisë paguese.

194. Ministria përgjegjëse për financat do të informojë njësinë e vetëqeverisjes vendore për mbështetjen e disponueshme të qeverisë qendrore. Administratori do të përgatisë programet e asistencës financiare për njësinë e vetëqeverisjes vendore.

195. Brenda afatit kohor të propozuar të rehabilitimit financiar, të ardhurat korrente mund të rriten duke rritur:

- i. normën tatimore vendore;
- ii. zgjeruar bazën tatimore; dhe
- iii. përmirësuar mbledhjen e taksave nëpërmjet një administrimi më të mirë.

196. Gjithashtu, të ardhurat nga qiratë, tarifatat dhe të ardhurat e tjera jotatimore, mund të kontribuojnë në tepricën operationale brenda një periudhe planifikuese.

197. Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore në gjendjen e paaftësisë paguese vendosin për rritjen e normës së taksave, atëherë këto njësi duhet të vendosin si minimum të nivelit të taksave normën mesatare të njërive të vetëqeverisjes vendore me madhësi afërsisht të ngjashme.

198. Duke qenë se njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë një fond rezervë dhe një fond kontigjence deri në 3 për qind të buxhetit të miratuar në nivel vendor, ky fond mund të përdoret për shlyerjen e borxhit me miratimin e këshillit të NJVQV-së. Shuma e përdorimit të këtij fondi varet nga koha kur evidentohet rasti i njësisë së vetëqeverisjes vendore me paaftësi paguese (p.sh. nëse njësia evidentohet në dhjetor, atëherë e gjithë teprica e këtij fondi në këtë vit mund të shkojë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura).

199. Një mundësi tjetër është kredia afatshkurtër, e cila mund të përdoret, gjithashtu, për rifinancimin e detyrimeve të prapambetura më emergjente ose të borxhit me kushte më pak të favorshme.

200. Mundësia tjetër është edhe rishikimi ose frenimi i shpenzimeve vendore, e cila do të krijojë kursime për shlyerjen e borxhit në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Megjithatë, riorganizimi për pagesat në kohë të detyrimeve mund të krijojë fonde për pagesën e interesit ose faturat më urgjente nga furnitorët.

201. Shkurtimet e shpenzimeve do të ndikojnë në performancën e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përkundrajt këtyre veprimeve të propozuara, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të jetë në gjendje të garantojë aksesin në shërbimet themelore publike vendore të përcaktuara me ligj dhe t'i sigurojë ato në nivelin minimal. Këto standarde minimale janë përcaktuar në aneksin nr. 3.

202. Sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi për pronat e pushtetit vendor, vetëm pasuritë jopublike me status juridik të pronës private mund të përdoren si kolateral. Edhe për këtë grup të pasurive të paluajtshme vendore, shitja e aseteve duhet të bëhet në përputhje me strategjinë e menaxhimit të pronës publike vendore.

203. Klasifikimi i kolateralit si pasuri, që mund të shitet sipas strategjisë së miratuar të menaxhimit të pronës, duhet të bëhet me vendim të këshillit të njësisë vetëqeverisjes vendore. Vlerësimi i aseteve

dhe i procedurave për tjetërsim duhet të mbështeten edhe në strategjinë e menaxhimit të aseteve publike vendore.

Raportimi mbi gjendjen e paaftësisë paguese

204. Ministria përgjegjëse për financat dhe këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore informohen për zbatimin e planit të rehabilitimit financiar çdo muaj.

205. Vendimi i këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, vendimi i Këshillit të Ministrave për menaxhimin e situatës së paaftësisë paguese dhe plani financiar i veprimit do të publikohen në faqen zyrtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Dalja nga gjendja e paaftësisë paguese

206. Afati i rikuperimit dhe i arritjes së gjendjes normale financiare është 2 vjet.

207. Njësia e vetëqeverisjes vendore e marrë nën administrim del nga gjendja e paaftësisë paguese dhe rikthehet në menaxhimin dhe funksionimin e saj normal, sipas përcaktimeve ligjore, vetëm kur vërtetohet se ajo është në gjendje të shlyej pa vonesa të gjitha detyrimet financiare të prapambetura ndaj të tretëve.

208. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore së bashku me administratorin hartojnë një raport për gjendjen financiare të njësisë së marrë në administrim dhe e dërgon për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat.

209. Pas shqyrtimit të raportit, por jo më vonë se 30 ditë nga marrja e tij, ministri përgjegjës për financat i propozon Këshillit të Ministrave daljen nga paaftësia paguese të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kthimin e saj në funksionimin normal, sipas parashikimeve ligjore. Administrimi i kontrolluar i njësisë së vetëqeverisjes vendore me administrator përfundon me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese. Në këtë kohë njoftohet këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore mbi vendimin e Këshillit të Ministrave për daljen e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga gjendja e paaftësisë paguese.

Tabela 6. Procedurat rehabilitimit të paaftësisë paguese

Nr.	Veprimet, hapat	Personi/institucioni përgjegjës	Afati
1.	Njohja e paaftësisë paguese	MFE, NJVQV-ja, kryetari	Në çdo kohë
2.	Vendosja e NJVQV-së nën administrimin e kontrolluar, emërimi i administratorit	Këshilli i Ministrave	Brenda 15 ditëve nga konstatimi
3.	Plani i rehabilitimit financiar dhe termat e zbatimit	Këshilli i Ministrave	Brenda 15 ditëve nga konstatimi
4.	Aplikimi i asistencës financiare	Këshilli i Ministrave, Administratori	Vazhdimisht
5.	Procesi i zbatimit	Administratori	Vazhdimisht
6.	Raportimi për zbatimin të MFE-ja, informimi i NJVQV-së dhe i këshillit	Administratori	Çdo 30 ditë
7.	Kërkesë për ndërprerjen duke ulur detyrimet e prapambetura nën kufirin për dy vite të njëpasnjëshme	Këshilli i NJVQV-së	Pas dy vjetëve
8.	Dalja nga gjendja e paaftësisë paguese	Këshilli i Ministrave	15 ditë

V. PROCEDURA PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI I KALUAR, QË DO TË PËRDOREN PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DHE PAGIMIN E NËNHUAVE TË PAPAGUARA NË KOHË TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

210. Të ardhurat e buxhetit vendor, të arkëtuara në llogaritë e thesarit nga taksat vendore, taksat kombëtare dhe transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit, të papërdorura gjatë vitit buxhetor, trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës.

211. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë dhe në bazë të aktrakordimit të mbajtur me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë do të

raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe strukturën përgjegjëse për financat vendore në ministrinë përgjegjëse për financat brenda muajit janar të vitit pasardhës për fondet e trashëguara.

212. Nga fondet e trashëguara, sipas aktrakordimit me degën përkatëse të thesarit, njësia e vetëqeverisjes vendore do të përdorë jo më pak se 30 për qind e tyre për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe pagimin e nënshkrimeve të papaguara në kohë në rast se ka të tilla, brenda datës 31 mars të vitit aktual.

213. Radha e kryerjes së këtyre pagesave duhet të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim dhe në udhëzimin nr. 9 datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

214. Njësia e vetëqeverisjes vendore për pjesën e detyrimeve të prapambetura dhe nënshkrimeve të papaguara, që ka shlyer në zbatim të pikës 1, të nenit 60/1, të ligjit 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, duhet të raportojë në ministrinë përgjegjëse për financat, brenda datës 10 prill, faktin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, plotësuar sipas formatit në aneksin 5, bashkëlidhur udhëzimit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

215. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

216. Udhëzimi nr. 26, datë 27.9.2019, shfuqizohet.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ervin Mete

ANEKSI 1

BASHKIA/ KËSHILLI I QARKUT _____									
					Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare				
Muj _____					Nëlekë				
NR	Emërtimi	Stok në vlerë	Spenzime vjetore faktike për NJMQV-në	Stoku/Spenzime vjetore faktike të NJMQV-së	Rasti i vështirësive kombëdhetësie e vetëqenies vendore				
					Situata Normale e gjendjes financiare	Probleme financiare Stoku i detyrimeve/Spenzime > 15%	Vështirësi financiare Stoku i detyrimeve/Spenzime > 25%	Vështirësi serioze financiare Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Spenzime > 80%	Pasfisi pagurse Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Spenzime > 130%
I	Borxhe (a+b)	0							
a	Has afatgjatë	0							
	a.1 Marëveshje financiare (kred, qira financiare, oer								
	a.2 Tituj të emetuar								
	a.3 Garanci për të tretë								
b	Has afatshkurtër	0							
	b.1 Marëveshje financiare (kred, qira financiare, oer								
	b.2 Tituj të emetuar								
	b.3 Garanci për të tretë								
II	Detyrimet e prapambetura	0			#DIV/0!				
Hogaria e borxheve	Emërtimi								
4864100	Vërdine Gjyqësore								
4864200	Det.Prap. Sherbime								
4864201	D.P. Ereni/Dektirke								
4864300	Det.Prap.Mirëmbajtje								
4864400	Det.Prap. Investime								
4864500	Det.Prap.Rëndituri TVSH								
4864600	Mallia								
4864600	Det.Prap.Të Tjera								
4864601	Det.Prap.Sig.Sherqetore								
4864602	Det.Prap.Sig.Sherdet								
4864603	Det.Prap.Archi Personal								
4864604	Det.Prap.Tatine Tjera								
4864601	Paga								
4864602	Siprocimit								
4864603	Trans.Indiv								
4864604	Trans.Subjektet								
III	Totali (I+II)	0			#DIV/0!				

ANEKSI 2
TREGUESIT FISKALË TË KONSOLIDUAR TË NJËSISË TË VETËQEVERISJES VENDORE¹

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	0	0
1	Taksat e veta vendore	0	0
a.	Taksa mbi pasurinë		
b.	Biznesi i vogël		
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja		
d.	Taksa të tjera vendore		
2	Të ardhura jotatimore	0	0
a.	Tarifat e shërbimeve publike		
b.	Tarifa administrative		
c.	Të tjera jo tatimore		
3	Taksa të ndara	0	0
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme		
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura		
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale		
e.	Të tjera		
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	0	0
1	Shpenzime Korrente	0	0
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga		
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore		
d.	Shpenzime Operative		
e.	Të tjera korrente		
2	Shpenzime Kapitale		
3	Burimet e Financimit	0	0
a.	Të ardhurat e veta vendore		
b.	Transferta e pakushtezuar		
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale		
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

ANEKSI 3
NIVELI MINIMAL (BAZË) I SHËRBIMEVE PUBLIKE QË OFROJNË NJVQV-të

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të ofrojnë një gamë (volum) të gjerë shërbimesh publike. Këto shërbime janë pjesë e funksioneve të veta të vetëqeverisjes vendore të përcaktuara me ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

¹ Tabela e mësipërme plotësohet në rakordim mes degës së Thesarit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe duhet të jetë e përfunduar brenda datës 20 të muajt pasardhës. Brenda datës 20 të muajt pasardhës të katërmujorit kjo evidencë e rakorduar mes degës së thesarit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Disa nga këto funksione janë:

- infrastruktura dhe shërbimet publike;
- shërbimet sociale;
- kultura, sporti dhe shërbimet rekreative;
- mbrojtja e mjedisit;
- bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat, natyra dhe biodiversiteti;
- zhvillimi ekonomik vendor;
- siguria publike;
- etj.

2. Format aktuale dhe niveli specifik i performancës së këtyre shërbimeve publike përcaktohen nga këshilli i njësish të vetëqeverisjes vendore brenda kornizës së përcaktuar me aktet ligjore dhe nënligjore sektoriale. Sipas nenit 33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitet e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të performancës së shërbimeve publike, në bazë të standardeve vendore dhe/ose standardeve kombëtare minimale.

3. Aktet nënligjore duhet të specifikojnë këto standarde minimale kombëtare. Nëse nuk janë të disponueshëm, ministria përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse dhe përfaqësuesit e shoqatave të vetëqeverisjes vendore, do të përcaktojnë përmbajtjen e këtyre shërbimeve dhe standardet minimale të performancës.

4. Shërbimet dhe standardet minimale të performancës duhet të komunikohen në formën e specifikimeve të detajuara të shërbimeve publike vendore dhe duke përcaktuar treguesit e performancës së shërbimit (*output*). Këta tregues duhet të jenë të kuptueshëm dhe të matshëm, në mënyrë që njësia e vetëqeverisjes vendore të jetë në gjendje t’i përdorë ato gjatë hartimit të planit të rehabilitimit financiar.

5. Nëse standardet minimale nuk janë të disponueshëm, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet t’i ofrojë këto shërbime të paktën në nivelin e 75 për qind të mesatares kombëtare, ose në të njëjtin nivel performance të shërbimit të ofruar në vitin e paraardhës, cilido nivel është më i ulët. Një listë e mundshme e shërbimeve minimale me treguesit specifikë të performancës është përshkruar në tabelën më poshtë.

6. Në situatën e vështirësisë serioze financiare, për të ofruar shërbimet publike minimale do të financohen vetëm institucionet që ofrojnë këto shërbime, të cilat shfrytëzojnë kapacitetet e tyre nominale në mënyrë efektive. Kështu që institucioni që ofron shërbimin, i cili vepron nën 50 për qind të kapacitetit të tij nominal, duhet të përjashtohet nga plani i rehabilitimit financiar. Kjo duhet t’i nxisë njësitet e vetëqeverisjes vendore që të riorganizojnë ofrimin e shërbimeve publike dhe të operojnë vetëm në njësinë e shërbimit që është më afër kapacitetit të tij optimal.

7. Në situatën e paaftësisë për të ofruar shërbimet publike minimale do të financohen vetëm institucionet që ofrojnë këto shërbime, të cilat shfrytëzojnë kapacitetet e tyre nominale në mënyrë efektive. Kështu që, institucioni që ofron shërbimin, i cili vepron nën 50 për qind të kapacitetit të tij nominal, duhet të përjashtohet nga plani i rehabilitimit. Kjo shërben si nxitje për njësitet e vetëqeverisjes vendore që të riorganizojnë ofrimin e shërbimeve publike dhe të operojnë vetëm me njësinë e shërbimit që është më afër kapacitetit të tij optimal.

Nr.	Niveli minimal i shërbimeve publike	Treguesit e rezultatit të performancës së shërbimeve	Niveli i performancës së shërbimeve publike
1.	Menaxhimi i shërbimeve të përgjithshme publike (administrim/planifikim)	Nëpunës civil për 1,000 banorë	
2.	Furnizimi me ujë	Vëllimi i ujit (m ³) për banor	
3.	Menaxhimi i ujërave të zeza	Sasia e ujërave të zeza në % për tubacion	
4.	Mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore	Gjatësia e rrugëve lokale (km) për çdo sinjalistikë rrugore	
5.	Ndriçimi i mjediseve publike	Përqindja e rrugëve të ndriçuara	
6.	Transporti publik vendor	Pasagjer-km shërbim për km ² në zonat urbane	
7.	Mirëmbajtja e varrezave publike	Kapaciteti i varrezave publike për 1,000 banorë	
8.	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta	Vëllimi i mbetjeve të ngurta të mbledhura për popullsi	
9.	Menaxhimi i godinave të arsimit	Sipërfaqja e godinës për 1,000 banorë	

	parauniversitar		
10.	Menaxhimi i kopshteve dhe i çerdheve	Përdoruesit në % të popullsisë brenda grup-moshës që përfiton këtë shërbim. Shërbimi minimal: përdoruesit aktualë në përqindje të kapacitetit nominal është më i lartë se 50%	
11.	Menaxhimi i godinave të shërbimit të kujdesit parësor	Përdoruesit në % të popullsisë brenda grup-moshës që përfiton këtë shërbim. Shërbimi minimal: përdoruesit aktualë në përqindje të kapacitetit nominal është më i lartë se 50%	
12.	Menaxhimi i qendrave të shëndetit publik	Punonjës për 1,000 banorë	
13.	Menaxhimi i shërbimeve sociale	Punonjës për 1,000 banorë	
14.	Menaxhimi i qendrave të shërbimeve sociale	Punonjës për 1,000 banorë	
15.	Menaxhimi i banesave sociale	Numri i banesave sociale në % ndaj totalit të njësive të banesave sociale	
16.	Menaxhimi i qendrave kulturore	Punonjës për 1,000 banorë	
17.	Mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit	Gjatësia e rrjetit të ujitjes për sipërfaqe të zonave urbane (km ²)	
18.	Administrimi i pyjeve dhe i kullotave	Zona pyjore në % ndaj sipërfaqes së zonave urbane	
19.	Mbikëqyrja e tregut	Njësitë në tregjet publike për 1,000 banorë	
20.	Menaxhimi i emergjencave civile	Njësitë e emergjencave civile për 1,000 banorë	
21.	Sigurimi i mbrojtjes nga zjarri (shërbimi zjarrfikës)	Popullsia 1,000 për zjarrfikës	

ANEKSI 4

PLANI PËR DALJEN NGA SITUATAT E VËSHTIRËSIVE FINANCIARE

Plani i rehabilitimit financiar dhe masat e marra janë programet bazë për menaxhimin e vështirësisë financiare.

Klasifikimi i borxhit

Detyrimet e papaguara ndaj të tretëve, sipas grupeve kryesore janë:

- i. hua;
- ii. obligacione;
- iii. garanci;
- iv. detyrimet e prapambetura;
- v. detyrime të tjera;
- vi. detyrimet e papaguara ndaj të tretëve të kompanive në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore (njësitë jobuxhetore) etj.

Përfshirja e planit të rehabilitimit në programin buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Plani i rehabilitimit financiar duhet të zhvillohet brenda kuadrit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Hapat që do të ndiqen në përfshirjen e planit të rehabilitimit në planet vendore të sipërcituara janë të specifikuar në legjislacionin në fuqi. Buxhetimi i planit të rehabilitimit financiar nga njësia e vetëqeverisjes vendore do të mbështetet në procedurat dhe rregullat që përcaktojnë aktet nënligjore për hartimin e programit buxhetor afatmesëm.

Për hartimin e planit të rehabilitimit njësia e vetëqeverisjes vendore duhet që të mbajë parasysh që në mënyrë periodike të vlerësohen të ardhurat dhe shpenzimet që njësia e vetëqeverisjes vendore realizon. Përmes këtij verifikimi, njësia mban nën kontroll balancën fiskale mujore dhe, gjithashtu, ajo përcakton ecurinë e zbatimit të planit të rehabilitimit financiar. Përmes monitorimit dhe përfshirjes së planit të rehabilitimit në programin buxhetor afatmesëm, njësia e vetëqeverisjes vendore bashkë me raportin e monitorimit të buxhetit, duhet të monitorojë dhe zbatimin e planit të rehabilitimit financiar.

Tabela më poshtë paraqet një model për mënyrën e strukturimit të dhënave fiskale aktuale dhe atyre të planifikuara, sipas planit të rehabilitimit financiar të miratuar.

Gjendja financiare e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Nr.	Emërtimi	Viti t	Viti t+1	Viti t+2
<i>A</i>	<i>Të ardhurat korrente</i> Nga të cilat: <i>të ardhura të veta</i> <i>Grante, transferata</i>			
<i>B</i>	<i>Shpenzime korrente</i> Nga të cilat: <i>Shpenzime operative dhe mirëmbajtje</i> <i>Interesa</i>			
<i>C</i>	<i>Balanca operative: C=A-B</i>			
<i>D</i>	<i>Shpenzime kapitale</i> Nga të cilat: <i>shpenzime për investime kapitale</i> <i>Transferata kapitale, subvencione</i> <i>Shpenzime për shlyerjen e principalit të huas</i> <i>Blerja e asetëve financiare</i>			
<i>E</i>	<i>Të ardhurat kapitale</i> Nga të cilat: <i>grante, transferata</i> <i>Shitja e asetëve</i> Financime të tjera Nga të cilat: <i>huat</i> <i>Rezerva e parasë cash</i>			
<i>F</i>	<i>Balanca financiare: F=C+E-D</i>			

Veprimet që propozohen të ndiqen në procesin e rikuperimit

Gjatë procesit të rikuperimit financiar njësjë e vetëqeverisjes vendore mund të modifikojë kuadrin ligjor dhe financiar ekzistues dhe mund të propozojë ristrukturim të rëndësishëm të treguesve fiskal, si në të ardhura, ashtu edhe në shpenzime, me qëllim shlyerjen e borxheve dhe detyrimeve të prapambetura.

Plani i rehabilitimit financiar do të përfshijë masat që do të ndërmerren, me qëllim balancimin e financave vendore dhe menaxhimin e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve. Plani i rehabilitimit financiar duhet të jetë me bazë mujore dhe të jenë përcaktuar qartë përgjegjësitë për zbatimin e tij. Plani i rehabilitimit mund të përfshijë ndryshimet, si më poshtë:

Rritja e të ardhurave

Rishikimi i planit të të ardhurave vendore duhet të synojë kryesisht burimet e financimit nga të ardhurat e veta, duke rivlerësuar në këtë mënyrë mundësitë për rritjen e taksave, tarifave, masave administrative etj. Planifikimi i të ardhurave duhet të ndjekë rregullat e miratuara të ndarjes së të ardhurave duke u përqendruar në nivelin e taksave, zgjerimin e bazës së të ardhurave dhe përmirësimin e eficiencës së administratës tatimore. Krahas mundësisë për rritjen e burimeve për shlyerjen e detyrimeve nëpërmjet fondit rezervë dhe të kontigjencës, njësitë e vetëqeverisjes vendore në vështirësi financiare mund të përdorin huamarrjen afatshkurtër dhe transfertat e buxhetit qendror për daljen nga vështirësitë financiare të njësjëve të vetëqeverisjes vendore.

Rishikimi i shpenzimeve

Politikat e shpenzimeve mund të krijojnë fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe borxhit në periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Megjithatë, riorganizimi për pagesat në kohë të detyrimeve mund të krijojë fonde për pagesën e faturave më urgjente të furnitorëve, interesin dhe principalin e huave të njësjës së vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në vështirësi financiare, nuk duhet të rrisin detyrimet e tyre financiare, duke ofruar shërbime të reja, apo të ndërmarrin veprime të tjera. Përmes rishikimit të shpenzimeve do të synohet mbulimi me fonde publike të nivelit minimal të shërbimeve publike dhe fondet e tjera do të orientohen drejt uljes së detyrimeve të njësjës së vetëqeverisjes vendore.

Menaxhimi i asetëve

Strategjia e miratuar vendore e menaxhimit të asetëve duhet të ndajë pasuritë fizike vendore të përdorura për shërbimet publike kryesore për zhvillimin vendor dhe pasuritë e tjera të njësjës. Grupi i fundit mund të përdoret për të paguar kreditorët dhe për të shlyer detyrimet e njësjës. Informacioni për asetet financiare në lidhje me paranë e gatshme dhe llogaritë e arkëtueshme duhet të shërbejë edhe në funksion të planifikimit të shlyerjes së detyrimeve financiare. Këto asete që nga përdorimi i tyre nuk cenohet veprimtaria e njësjës së

vetëqeverisjes vendore, mund të përdoren me qëllim uljen e detyrimeve të prapambetura dhe shlyerjen e borxhit që ka krijuar njësi e vetëqeverisjes vendore.

Programi i negocimit

Bazuar në klasifikimin e hollësishëm të borxhit vendor dhe detyrimeve të prapambetura, njësi/personi i ngarkuar me zbatimin e planit të rehabilitimit vendor, mbikëqyrësi financiar dhe administratori mund të fillojnë hartimin e programit për shlyerjen e detyrimeve dhe uljen e borxhit publik. Ky program do të klasifikojë shpërndarjen e faturave të papaguara, kësteve të ristrukturuara dhe asetëve të ndara të disponueshme të njësisë së vetëqeverisjes vendore midis kreditorëve të njësisë. Në këtë kontekst, hartohet një plan i veçantë masash për zhvillimin e negociatave.

Plani i menaxhimit të borxhit

Informacioni i detajuar mbi të gjitha detyrimet e papaguara ndaj të tretëve së bashku me rreziqet që këto detyrime mbartin, përbën bazën për zhvillimin e planit për shlyerjen e borxhit. Propozimi për detyrimet me prioritet duhet të ndjekë parimet kryesore udhëzuese për të shmangur praninë e vazhdueshme të borxhit, për priorizimin e detyrimeve tatimore dhe më pas për të paguar detyrimet e prapambetura.

Plani i shlyerjes së borxhit

Nr.	Huat	Viti t	Viti t+1	...	Viti t+n
1	Hua 1 (stoku i detyrimit mbetur për likuidim)				
2	Pagesa e principalit				
3	Interesa				
4	Detyrimi total				

Përdorimi i burimeve potenciale financiare duhet të përputhet me detyrimet për një periudhë afatmesme. Plani i menaxhimit të borxhit duhet të rishpërndajë të ardhurat e veta, ndihmën financiare nga buxheti qendror, rezervat e *cash*-it (parasë së gatshme), kreditë afatshkurtër (marrje kredi për të shlyer detyrimet), asetet e disponueshme fizike etj.

Monitorimi dhe vlerësimi

Plani i rehabilitimit financiar duhet të përfshijë tregues të matshëm të synuar, të cilët do të mundësonin vlerësim të rregullt gjatë procesit të zbatimit. Raporti përfundimtar vendor për daljen nga gjendja e paaftësisë duhet të përfshijë pagesat e pezulluara përkohësisht të borxhit të mbetur dhe detyrimeve të prapambetura.

ANEKSI 5

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe nënshuave të papaguara me fondet e trashëguara

Bashkia/Këshilli i qarkut _____

në lek

Nr.	Emërtimi	Stoku i detyrimeve të prapambetura/ nënshuave deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës	Vlera e shlyer e detyrimeve/ nënshuave me fondet e trashëguara deri në 31 mars të vitit korrent
I	Borxhe (a+b)	0	0
a	Hua afatgjatë	0	0
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, <i>overdraft</i> etj.)		
a.2	Tituj të emetuar		
a.3	Garanci për të tretë		

b	Hua afatshkurtër	0	0
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj.)		
b.2	Tituj të emetuar		
3	Garanci për të tretë		
II	Detyrimet e prapambetura	0	0
Llogaria ekonomike	Emërtimi		
4864100	Vendime gjyqësore		
4864200	Det. prap. shërbime		
4864201	DP energji elektrike		
4864300	Det. prap. mirëmbajtje		
4864400	Det. prap. investime		
4864500	Det. prap. rimbursi, TVSH		
4864600	Mallra		
4864900	Det. prap. të tjera		
4864601	Det. prap. sig. Shoqërore		
4864602	Det. prap. sig. shëndet.		
4864603	Det. prap. ardh. personale		
4864604	Det. prap. tatime tjera		
4864901	Paga		
4864902	Shpronësime		
4864903	Trans. indiv		
4864904	Trans. subjektet		
III	Nënhuat		
IV	Totali (I+II+III)	0	0

Nëpunës zbatues

(_____)

Nëpunësi autorizues

(_____)

Shënim. Në tabelën e aneksit 5, në pikën III “Nënhuat”, përfshihen të gjitha nënhuat, të cilat nuk janë pjesë e pikës I, “Borxhe”.